



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Prave – Ministry of Justice

Zyra e Sekretarës së Përgjithshme – Kancelarija Generalnog Sekretara – Office of the
General Secretary

Nr. 148 /2024

Datë: 18/11/2024

Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7 / 01 mars 2019, bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik të Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar me Ligjin nr. 05/L-68, pjesa IV, neni 81, si dhe neni 70, Rregullores për Prokurim Publik me nr. 002/2024, mbi aktivitetin e menaxhimit të Kontratës, Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Drejtësisë nxjerr këtë:

V E N D I M

1. znj. Arbresha Lajqi, Zyrtare e Lartë për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së punës të Profesioneve të Lira, caktohet menaxhere e kontratës ku ka për detyrë menaxhimin e kontratës, dhe mbikëqyrjen e realizimit të obligimeve dhe detyrave kontraktuese të specifikuar si në kontratë me titull: **“Shërbime të ndryshme kontraktuese për mbajtjen e aktiviteteve kundër dhunës me bazë gjinore, me numër të kontratës: 21500-24-10672-2-2-1/C112**
2. Zyrtari përgjegjës për menaxhimin e kontratës nga pika 1 e këtij vendimi ka për detyrë që:
 - 2.1. Të sigurojë që operatori ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës apo dërgesës në përputhje me termat e referencës dhe kushtet e kontratës;
 - 2.2. Të sigurojë që operatori ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 2.3. Të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;

Faqe 1 nga 2

- 2.4. Të siguroj se ka kontroll adekuat të kostove, cilësisë dhe kohës aty ku është e përshtatshme;
- 2.5. Të siguroj që të gjitha obligimet janë kompletuara para mbylljes së dosjes së kontratës;
- 2.6. Të siguroj që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të mbahen dhe arkivohen siç kërkohet;
- 2.7. Të nxjerr variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- 2.8. Të siguroj detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës Divizionit të Prokurimit dhe ta merr miratimin;
- 2.9. Të menaxhojë dorëzimin e procedurave të pranimit;
- 2.10. Të jep detaje të plota për ndonjë ndërprerjeje të propozuar të kontratës Divizionit të Prokurimit dhe
- 2.11. Të dorëzoj raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate siç kërkohet nga ZKA dhe Divizionin i Prokurimit.

3. Obligohet i lartcekuri që detyrat dhe përgjegjësitë e tij ti kryej në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Vendimi i'u dërgohet:

- znj. Arbresha Lajqi
- Kabinetit të Ministrës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme;
- Divizionit të Prokurimit; dhe
- Arkivit të MD-së.

Faqe 2 nga 2